REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 609/23
Datë/Datum. 29.08.2023
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Nr.609/ 23

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik ENERGON L.L.C., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me klima për objektet e PK-së" me numër të prokurimit 214-23-6032-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me 29/08/2023, mori këtë:

VENDIM

Hedhet si e palejuar, ankesa e "ENERGON" L.L.C. me Nr. të Protokollit 2023/0609, e datës 23/08/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me klima për objektet e PK-së", me numër të prokurimit 214-23-6032-1-2-1, iniciuar nga POLICIA E KOSOVËS në cilësinë e autoriteti kontraktues (AK).

I lejohet autoritetit kontraktues – POLICIA E KOSOVËS që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me klima për objektet e PK-së", me numër të prokurimit 214-23-6032-1-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej

gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 23.08.2023, ka pranuar ankesën me Nr.Protokolli 609/23 nga OE "ENERGON" L.L.C. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me klima për objektet e PK-së", me numër të prokurimit 214-23-6032-1-2-1, inicuar POLICIA E KOSOVËS në cilësinë e Autoriteti Kontraktues.

Me 04.08.2023, POLICIA E KOSOVËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B58-Njoftimin mbi Vendimin e AK.

Me 10.08.2023 OE "ENERGON" L.L.C. kishte bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Ndërsa me datë 14.08.2023 AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik si të jashtafatshme.

- Administrimi dhe Vlerësimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me klima për objektet e PK-së", me numër të prokurimit 214-23-6032-1-2-1, iniciuar nga POLICIA E KOSOVËS në cilësinë e autoriteti kontraktues (AK). AK ka publikuar njoftimin- B58 është në sistemin e-prokurimi me datë 04.08.2023. Ndërsa me datë 10.08.2023 OE ENERGON L.L.C. kishte bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Autoriteti Kontraktues me datën 14.08.2023 AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik si të jashtafatshme.

Ankuesi ka qenë i obliguar që në pajtim me paragrafin 3.2 të nenit 108/A të LPP-së, brenda afateve ligjore të parashtroj kërkesë për rishqyrtim në AK dhe vetëm pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK, Operatori ekonomik në pajtim me nenin 109 të LPP-së do të mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. Neni 108/A paragrafi 3.2 i LPP-së përcakton se operatori ekonomik ankues kërkesën për shqyrtim duhet të dorëzoj tek autoriteti përkatës kontraktues: *në*

qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit. Po ashtu, edhe neni 60.1 pika b) në Rregulloren 001/2022 për Prokurim Publik përcakton se: *Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK (B58) është dita (0).*

Nga shkresat e lëndës konstatohet se ankesa e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datë 23.08.2023, nga OE "ENERGON" L.L.C. për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me klima për objektet e PK-së" me numër të prokurimit 214-23-6032-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues AK –POLICIA E KOSOVËS, hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi nuk ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim brenda afateve ligjore kundër njoftimit të Autoritetit Kontraktues. Andaj Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake të rregullt dhe brenda afateve ligjore pranë AK, ankuesi mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së.

Si përfundim kjo ankesë është në kundërshtim me nenin 108/A dhe 109 të Ligjit për Prokurim Publik, dhe nenit 60 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, dhe si e tillë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

OSHP gjithnjë niset nga rregullat, zgjidhjet dhe parimet e LPP sipas të cilit secili AK ushtron pavarësinë e tij/sajë në kuptim të nenit 8 dhe 9 lidhur me planifikimin e prokurimit dhe parashikimin e nevojave, mirëpo kriteret e parapara gjithnjë duhet ta garantojnë barazinë e OE të cilët parashihen si të tillë edhe me DT e cila në kuptim të nenit 27, lidhur me nenin 28, përbën dokumentin kyç të prokurimit publik. Andaj, Autoritetit kontraktues – POLICIA E KOSOVËS, mund të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit (e përshkruar me sipër) nëse nuk ka ankesë tjetër për këtë aktivitet. Organi Shqyrtues i Prokurimit i vë në dijeni se në çdo aktivitet AK duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60, 65 të LPP-së.

Lidhur me tarifën ankimore vendoset në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, që operatorit ekonomik ankues ti kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetarja e OSHP-së

Vjosa Gradinaj Mexhuani

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – POLICIA E KOSOVËS

1x1 OE ENERGON L.L.C.

1x1 Arhivës së OSHP-së;